



Datë: 10.03.2025
Numër Protokolli: 1600/2025

A.nr.161/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.161/2025 të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesja, A.C-R, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.161/2025 të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesja, A.C-R.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, A.C-R, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 22.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 429/2025, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.161/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Konkursit me numër reference RN00015137, të shpallur me datë 13.09.2024 nga Inspektorati i Punës, për pozitën e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Ferizaj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës, më datë 13.09.2024 ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00015137, për shtatë (7) pozitë e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Ferizajit, ku afati për aplikim ka qenë nga data 14.09.2024 deri më 13.10.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 147 kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja, të cilës sipas Vendimit të datës 25.10.2024, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka bashkangjitur dëshmitë për përvojën e punës së kërkuar dhe në këtë mënyrë nuk është përfshirë në fazën tjetër të vlerësimit të kandidatëve për konkursin përkatës.

Tutje, Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës, më datë 24.12.2024 ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 3377, për shpalljen e kandidatëve fitues, nga i cili njoftim rezulton se procedura e rekrutimit për shtatë (7) pozitat e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Ferizajit, ka përfunduar me dhjetë (10) kandidatë të suksesshëm, me pikët e përgjithshme, si vijon: Xh.L me 94.2 pikë, A.Sh me 92.6 pikë, M.H me 91.4 pikë, G.H me 86 pikë, M.J-N me 81.4 pikë, B.S-A me 79.8 pikë, L.J me 78.6 pikë, V.D-L me 78.4 pikë, V.A me 73.4 pikë dhe M.H me 70.2 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës, ashtu që kërkon rishqyrtimin apo rivlerësimin e vendimit për refuzimin e aplikacionit të saj.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuses të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur me Vendimin A.nr.144/2025 të datës 27.02.2025, me të cilin vendim është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015137, për shtatë (7) pozitat e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Ferizajit, i shpallur më datë 13.09.2024 nga Inspektorati i Punës, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.144/2025 të datës 27.02.2025 është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015137, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”.**

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.161/2025, të datës 22.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.161/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses, A.C-R;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*